

8 dhjetor 2025,
Prishtinë

Vendim i Bordit të FBK-së i datës 08.12.2025, Prishtinë

Lejimi i një lojtare shtesë të huaj për ndeshjet në kuadër të Ligës Unike (Femrat)

Në përputhje me kompetencat e përcaktuara për Bordin e Federatës së Basketbollit të Kosovës, sipas nenit 24 të Statutit të FBK-së, dhe pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur dhe arsyetimin e bashkëngjitur, më 08.12.2025, Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) vendos se:


Lejohet regjistrimi dhe paraqitja e një lojtare shtesë të huaj nga klubet pjesëmarrëse të Federatës së Basketbollit të Kosovës në garat e Ligës Unike (Femrat), vetëm për ndeshjet kundër ekipeve të anëtarësuara në Federatën Shqiptare të Basketbollit.

Lejimi i një lojtareje shtesë të huaj synon të balancojë konkurrencën, pasi ekipet e FSHB-së veprojnë me rregulla të ndryshme sa i përket lojtareve të huaja. Ky rregull rrit nivelin dhe cilësinë teknike të Ligës Unike, mbështet klubet tona në menaxhimin e ngarkesës së ndeshjeve dhe zbatohet vetëm për përballjet kundër ekipeve të FSHB-së, pa ndikuar në garat vendore të FBK-së.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben FETAHU



Federata e Basketbollit të Kosovës

